

PORTOFOLI I TË NXËNIT

TREGUES I ARRITJES SË KOMPETENCAVE

UDHËZUES PËR MËSUESIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

BAZË PËR ZHVILLIM DHE ORIENTIM TË
SUKSESSHËM TË NXËNËSIT

Grupi i punës:

Zamira Gjini
Dr. Gerti Janaqi
Dr. Mirela Andoni
Ines Todhe
Aurela Zisi

Moderatore:

Dr. Mirela Andoni

Redaktimi shkencor:

Dr. Mirela Andoni

Redaktimi letrar

Petrit Zili

Ky manual reflekton rezultatet e procesit të pilotimit të portofolit të të nxënit me mësuesit e shkollave që pilotojnë kurrikulën e re.

78 mësues të 26 shkollave pilot përfaqësojnë grupin e përfshirë në pilotim.

(Manuali u financua nga “Kulturkontakt Austria”)

Përmbajtja

Përmbajtja	3
I. Hyrje	4
II. Kuptimi dhe rëndësia e portofolit të të nxënit	5
III. Përmbajtja e portofolit të të nxënit	5
IV. Arsyet për portofolin e të nxënit.....	9
V. “Audienca” për portofolin e të nxënit.....	12
VI. Portofoli dhe procesi i të nxënit	13
VII. Vlerësimi i portofolit.....	15
VIII. Menaxhimi i cilësisë së portofolit të të nxënit dhe instrumentet për vetëvlerësimin e portofolit.	20
Referenca	23
Shtojca: Hapat për të planifikuar përmbajtjen e portofolit	24

I. Hyrje

Kurrikula bazuar në kompetenca që po zbatohet në sistemin arsimor parauniversitar, shoqërohet me një sërë dokumentesh përfshirë edhe portofolin e të nxënës.

Nëpërmjet këtij udhëzuesi parashtrohet rëndësia, përmbajtja dhe procedurat që duhen mbajtur parasysh për hartimin dhe vlerësimin e portofolit të të nxënës. Kjo qasje e re për shkollën është pilotuar me sukses nga 78 mësues të tri cikleve të arsimit bazë, nga klasa përgatitore, cikli fillor dhe cikli i mesëm i ulët nga të 13 DAR-et e vendit.

Udhëzuesi synon të mbështesë mësuesit në procesin e menaxhimit të portofolit të nxënësit si dhe vlerësimin e tij (nxënësit) edhe nëpërmjet portofolit.

Nëpërmjet portofolit mësuesi drejton nxënësit në koleksionimin e rezultateve/arritjeve të të nxënës sipas një rendi të mirëstrukturuar me qëllim vlerësimin, vetëvlerësimin dhe shkëmbimin e këtyre arritjeve.

II. Kuptimi dhe rëndësia e portofolit të të nxënit


Portofoli i të nxënit është një qasje bashkëkohore që bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve në veprimtari mësimore të orientuara nga kompetenca.

Kurrikula e re kërkon një sërë dokumentesh mbështetëse për zhvillimin dhe demonstrimin e të nxënit. Në këtë kontekst, portofoli është një mjet që përdoret gjerësisht në praktikat më të përparuara bashkëkohore për koleksionimin e rezultateve të të nxënit. Ky proces realizohet si nga mësuesi (nëpërmjet “Portofolit të mësuesit”) ashtu dhe nga nxënësi (nëpërmjet “Portofolit të nxënësit”).

Referuar qasjes së re kurrikulare portofoli i të nxënit merr një vend të posaçëm pasi:

- ➔ **mbështet zbatimin** e kurrikulës të bazuar në kompetenca;
- ➔ **krijon qëndrueshmëri** në procesin e realizimit të saj;
- ➔ ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në **garantimin e cilësisë** së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënit.

Në këtë kontekst, ka vend për kujdesja për të unifikuar kuptimin mbi mënyrën se si do të menaxhohet ky proces dhe produkt nga mësuesi.



III. Përmbajtja e portofolit të të nxënit

Kurrikula e re e arsimit bazë, në themel të saj, ka krijimin i kompetencave të nxënësi. Si rrjedhojë, procesi i realizimit dhe i dokumentimit të të nxënit duhet të bazohet në atë çfarë arrin nxënësi të tregojë, të dëshmojë e të demonstrojë. Diane Hart përcakton një *portofol* si "një enë që mban evidencën e njohurive, të ideve, interesave dhe arritjeve".


Çfarë kuptojmë me kompetencë dhe si dokumentohet arritja e saj?

Përgjithësisht, *kompetenca* është "aftësia e individit për të demonstruar përmbushjen e një detyre, në një kontekst të dhënë". Për shembull, të zotërosh kompetencën e përdorimit të programit "Eord" në kompjuter, do të thotë që të jesh i aftë të demonstrosësh shkrimin e teksteve, ndërtimin e skemave dhe kryerjen e veprimeve të tjera në kuadrin e mundësive që të ofron programi "Eord" të kompjuterit.

Në arsim, më shumë kemi të bëjmë me *kompetenca* që tregojnë "aftësinë e nxënësit për të demonstruar përmbushjen me sukses (brenda disa kritereve) të një detyre të caktuar, në një kontekst të dhënë". Nga ky përkufizim, mund të themi se:

- kompetenca është ajo që realisht demonstrohet nga nxënësi dhe jo thjesht "potenciali" i tij;
- kompetenca është ajo që demonstron nga nxënësi në kontekste reale dhe jo thjesht në mjedise mësimore.

Kompetenca formulohet si tërësia e njohurive (Nj), e shprehive (Sh) dhe e qëndrimeve (Q) që demonstron një individ gjatë përmbushjes së detyrave të kërkuara në kushte të caktuara.



Këto tri elemente përbërëse të kompetencave ndërthuren dhe integrohen me njëra-tjetrën, duke krijuar te nxënësi kompetenca të plota dhe të qëndrueshme.

Kompetencat janë mjaft të rëndësishme sot për arsimin parauniversitar, i cili mund të emërtohet si “arsim i bazuar në kompetencat”.

Kompetencat janë mjaft të rëndësishme për funksionalitetin e individit në jetë dhe më pas edhe në tregun e punës.

Kompetencat janë të natyrave nga më të ndryshmet dhe kjo përcaktohet nga lloji dhe vëllimi i njohurive, i shprehive dhe i qëndrimeve. Kështu, kompetencat mund të jenë të gjera (p.sh., aftësia për të komunikuar) ose të ngushta (p.sh., aftësia për të shumëzuar numrat). Ato mund të jenë të përgjithshme (p.sh., aftësia për të planifikuar) ose të veçanta (p.sh., aftësia për të kryer mbledhje dhe zbritje të numrave).

Ka klasifikime të ndryshme të kompetencave, por përdorim më të gjerë në praktikën e sotme arsimore kanë:

- a. **Kompetencat kyçe/ të përgjithshme** (ose jetësore), ku më kryesoret janë aftësitë për të komunikuar, për të kryer llogaritje matematike, për të përdorur teknologjinë e informacionit, për të nxënë, për të planifikuar, për të ndërmarrë nisma, për të zgjidhur problemet jetësore, etj., që ndihmojnë çdo individ për të përballuar sfidat e jetës, pavarësisht veprimtarisë profesionale që ushtron.
- b. **Kompetencat e fushës/ lëndës** të cilat u referohen aftësive të lidhura ngushtësisht me aspekte shkencore të materies përkatëse.

Kompetencat janë të detyrueshme për nxënësit, ato përshkojnë filozofinë e kurrikulës së arsimit parauniversitar.

Sikurse në skemën më sipër ku njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet integrohen te kompetenca, edhe kompetencat e ndryshme ndërthuren me njëra-tjetrën dhe krijojnë atë që quhet formim i nxënësit.

Në fakt kjo është një analizë didaktike që i bëhet kompetencës, me qëllim planifikimin dhe realizimin e mësimin.

Pra, edhe në procesin mësimor, kompetencat realizohen të integruara.

Mësuesi në procesin e planifikimit, të realizimit dhe të reflektimit/vlerësimit mban parasysh përmbushjen nga nxënësi të të gjitha këtyre kompetencave.

Kjo është arsyeja e rëndësishme që merr portofoli si një mjet për të dokumentuar, treguar, krahasuar dhe vlerësuar mbërritjen të qëllimit të artikuluar në kurrikul.

Po t'i referohemi portofolit mund të themi se:

- ➔ portofoli është **pasqyrim i mësimeve të bazuar në dëshmi**;
- ➔ mësimeve dhe të nxënësve, të vështruara nëpërmjet portofolit, ndihmon të **eksplorojmë dhe të zhvillojmë qasjet për një mësim efektiv**;
- ➔ nëpërmjet portofolit **përthyhen dhe dokumentohen qasjet e mësimit të bazuar në kompetenca/performancën e nxënësit**;
- ➔ në thelbin e tij portofoli me dokumentacionin që e përbën, **argumenton përgjegjësitë e mësuesit në lidhje me mësimeve dhe të nxënësve**.

Mësimeve të bazuar në portofol është një proces që dokumenton:

- ✓ **filozofinë e mësimeve - Pse?**
- ✓ **përgjegjësitë e mësuesit - Çfarë? Kur? Ku?**
- ✓ **arritjet (nëpërmjet evidencave të vlerësimit) - Si?**

Metodologjia për projektimin e mësimit bazuar në kompetenca

Për të projektuar dhe planifikuar përmbajtjen e portofolit të nxënësit, mësuesi duhet të ndjekë metodologji që i referohen mësimit të bazuar në kompetenca si më poshtë:

A. Kryhet analiza didaktike e kompetencave, sipas hapave të mëposhtëm:

- evidentohen kompetencat kyçe dhe ato të lëndës;
- zërthehet kompetenca në përbërësit e saj: njohuri, shprehje, qëndrime. Pra, detajohen me tej rezultatet e të nxënësve (RN);
- konceptohet përmbajtja që do të trajtohet (faktet, konceptet, parimet, veprimtaritë, etj.);

- përcaktohet niveli i përmbushjes së kompetencës nga nxënësi (të dijë si kryhet, të ketë parë si kryhet, ta kryejë nën mbikqyrje, ta kryejë i pavarur, ta kryejë i pavarur në kushte/situata të ndryshme) *sipas cikleve të shkollimit*;
- përzgjidhet metoda mësimore që do të përdoret (shpjegim, demonstrim, ushtrim praktik i pavarur etj.) dhe koha që do të shpenzohet për të përvetësuar kompetencën;
- përcaktohen kushtet dhe mjetet që duhen për të përvetësuar kompetencën;
- përcaktohen rezultatet/detyrat që do të tregojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi;
- përcaktohen instrumentet dhe kriteret për vlerësimin e rezultateve/ detyrave që do të përmbushë nxënësi;
- përcaktohen se cilat rezultate/detyra do të koleksionohen në portofol.

B. Zhvillohen materialet didaktike për realizimin e mësimit të bazuar në kompetenca, referuar:

- metodave mësimore që do të përdoren (shpjegim, demonstrim, veprimtari praktike e pavarur etj.);
- veprimtarive, detyrave, projekteve për të përvetësuar kompetencën;
- situatave mësimore, kushteve dhe mjeteve që duhen për të përvetësuar kompetencën;
- instrumenteve dhe kriterëve për vlerësimin e nxënësit.

C. Evidentohet procesi i të nxënit të kompetencës:

- përcaktohen kriteret e vlerësimit;
- plotësohen evidencat e vlerësimit;
- dokumentohen arritjet e nxënësve.

IV. Arsyet për portofolin e të nxënit

Qasja me portofol i jep përgjigje pyetjeve:

- *Pse kompetencat e arritura nga nxënësit në arsimin parauniversitar duhet të dokumentohen?*
- *Sa ndikon dokumentimi dhe koleksionimi i arritjeve për njohjen dhe orientimin e mëtejshëm të nxënësve për studim dhe punësim?*

- *Si e nxit portofoli vetëdijësimin e nxënësve dhe të prindërve për nivelin e kompetencave, talentet, prirjet e tyre etj;*
- *Si e krijon mundësinë për t'i bërë të transferueshme dhe të adaptueshme kompetencat e fituara në sisteme të tjera arsimore?*

Kurrikula bazuar në kompetenca i është referuar kërkesës që vjen nga përmbushja e nivelit të parë të kualifikimit¹ sipas **Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, duke bërë të mundur elasticitetin e dijes edhe në sisteme të tjera arsimore.**

Pjesa më e madhe e vendeve të Bashkimit Europian kanë rënë dakord dhe kanë hartuar **Kornizën Europiane të Kualifikimeve (KEK)**, e cila është prezantuar zyrtarisht në vitin 2008.

Kjo kornizë shërben si një instrument “krahasimi” apo “përkthimi”, për t'i bërë kualifikimet më të lexueshme dhe më të kuptueshme nga vende dhe sisteme të ndryshme në Europë. Nëpërmjet KEK lehtësohet njohja e kualifikimeve (certifikatave), akumulimi dhe transferimi i arritjeve formale në kuadrin e të nxënësve gjatë gjithë jetës, si dhe mundësohet mobiliteti arsimor dhe profesional në kontekstin europian.

Korniza Europiane e Kualifikimeve e vë theksin te output-et, pra te rezultatet e të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve në këtë Kornizë janë të specifikuara në tri kategori – si ***njohuri, shkathësi (shprehi) dhe kompetenca të gjera (qëndrime).***

Kjo tregon se kualifikimet, në kombinime dhe nivele të ndryshme, përfshijnë një fushë të gjerë të rezultateve të të mësuarit, prej njohurive teorike, praktike dhe teknike, si dhe kompetencave kyçe, ku është vendimtare aftësia për të punuar me të tjerët.

Korniza e Kualifikimeve të Shqipërisë është një mjet për të reformuar sistemin e garantimit të cilësisë dhe të kualifikimeve, për të gjitha aspektet e arsimit. (Ligji Nr. 10247-“Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”

Pas mbarimit të arsimit bazë (AMU) nxënësi arrin nivelin I të kualifikimit sipas KSHK- Kualifikimi minimal për hyrje në punë ose jetë shoqërore (dëftesë lirimi).

Pas mbarimit të arsimit të mesëm të lartë (AML) trevjeçar nxënësi arrin nivelin IV të kualifikimit sipas KSHK - Matura e përgjithshme (Diploma e Maturës Shtetërore)

Nisur nga sa më sipër, si dhe kurrikulës të bazuar në kompetenca, *vlerësimi i performancës* dhe *monitorimi i vazhdueshëm i arritjeve të nxënësve* referuar jo vetëm rezultateve të të nxënësve të lëndës/fushës, por dhe kompetencave kyçe për gjatë gjithë jetës, merr një vlerë të veçantë.

Për sa më sipër, portofoli konsiderohet si një instrument që:

- ➔ mbështet realizimin e RN-ve;
- ➔ zgjeron gamën e elementeve që vlerësohen;
- ➔ krijon mundësi për të zbuluar te nxënësi një llojshmëri aftësish;
- ➔ krijon pasqyrë të ndryshimeve dhe përmirësimeve për një periudhë kohore;
- ➔ inkurajon nxënësit, mësuesin dhe mbështet reflektimin e prindërve;
- ➔ siguron vazhdimësinë në edukimin nga një vit në tjetrin.

Mësuesi mund t'i përdorë të dhënat e portofolit për qëllime të ndryshme specifike, duke përfshirë:

- ➔ nxitjen e të mësuarit të vetëdrejtuar;
- ➔ krijimin e një panorame të qartë të asaj që është mësuar nga nxënësi;
- ➔ nxitjen e të nxënësve për të nxënë;
- ➔ demonstrimin e progresit të nxënësit bazuar në rezultatet e identifikuara;
- ➔ nxitjen e mendësisë së vetëvlerësimit të nxënësit;
- ➔ ballafaqimin e dokumentuar të performancës së nxënësve me njëri-tjetrin dhe nxitjen e krijimtarsisë;
- ➔ përfshirjen e prindërve në procesin e të nxënësve.

Portofoli i të nxënësve është koleksionimi i kontributeve të nxënësit dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij në një lëndë apo në një fushë kurrikulare.


Portofoli i të nxënësve konceptohet dhe zhvillohet bazuar në qëllime të përcaktuara qartë.

Për të udhëhequr një portofol efektiv të të nxënësve, mësuesi duhet të mbështetet në katër ide bazë:

- hartimi i portofolit duhet të ***udhëhiqet nga funksioni që ai ka*** në zbatimin e kurrikulës me kompetenca;

- drejtimi, rubrikat dhe menaxhimi i portofolit duhet të marrë parasysh *moshën e nxënësit, nivelin e shkollimit;*
- portofoli i nxënësit (si për një lëndë/apo për të gjithë nivelin) *duhet të përmbajë një qëllim të shkruar qartë*, të lidhur për shembull me procesin e të nxënimit apo me arritjen e kompetencave;
- portofoli duhet të *evidentojë procesin e të nxënimit* nëpërmejt të dhënave dhe dokumenteve të ndryshme që nxënësi koleksionon (mbledh) dhe që mbështetin reflektimin e tij për të nxënëtit.

Portofoli përmban dokumente të arritjes si më poshtë:



V. “Audienca” për portofolin e të nxënit

Portofoli duhet të zhvillohet duke mbajtur parasysh audiencën specifike që ai ka, që përfshin:

- nxënësin;
- nxënësit e tjerë të klasës, nxënësit e klasave të tjera paralele, nxënësit e tjerë të shkollës;
- mësuesin e lëndës/ fushës;
- mësuesit e tjerë;
- prindërit;
- prindërit e nxënësve të tjerë;
- përfaqësues të komunitetit/bordit.

VI. Portofoli dhe procesi i të nxënit

Procesi i krijimit të portofolit përmirëson mundësitë për një mënyrë të re të të nxënit. Zakonisht, gjatë procesit tradicional të të nxënit synohet memorizimi i fakteve apo i informacioneve. Përdorimi i portofolit si arshivues dhe seleksionues i detyrave, ndikon në *një të nxënë të thellë*, duke krijuar mundësi për të integruar njohuritë e mëparshme dhe *konsideruar të nxënit e mëparshëm* në situata të ndryshme.

Si pjesë e këtij procesi nxënësi inkurajohet të shohë mbi detajet e njohjes. Nëpërmjet plotësimit dhe dokumentimit të detyrave përfshihen shumë aftësi të akumuluar duke e bërë *nxënësin të ketë një këndvështrim më të gjerë*.

Të menduarit për portofolin e aftëson nxënësin *të zhvillojë të mësuarit të bazuar në platformë* (platformën për portofolin e vet).

Ka disa hapa për zhvillimin e portofolit të të nxënit, të cilat përgjithësisht varen nga funksioni që ka portofoli në lidhje me:

- procesin e të nxënit;
- vlerësimin e arritjeve;
- motivimin e nxënësit;
- orientimin e nxënësit.

Procesi i hatimit të portofolit përcaktohet gjithashtu nga:

- karakteristikat e lëndës;
- niveli i shkollimit/ moshë e nxënësve;
- natyra e kompetencave kyçe;
- procesi i reflektimit dhe i vetëvlerësimit të nxënësit.

Karakteristikat e portofolit ndikohen gjithashtu nga cikli i shkollimit, si dhe roli që ka mësuesi në procesin e drejtimit të zhvillimit të përmbajtjes, menaxhimit dhe mbajtjes së portofolit.

Karakteristikat e portofolit të të nxënës:

- ➔ reflekton *rezultatet e identifikuarat të nxënësit* bazuar në pritshmëritë e RN të kurrikulës;
- ➔ përqendrohet në *përvojat e të nxënësve të bazuara në performancë*, si dhe në përvetësimin e kompetencave kyçe (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve);
- ➔ përmban *shembuj të punës që shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor* dhe jo në disa ditë të shkëputura të vitit;
- ➔ përmban *produkte të punëve të nxënësve që përfaqësojnë një shumëllojshmëri* rezultatesh për t'u vlerësuar;
- ➔ përmban një *shumëllojshmëri të modeleve të punës dhe vlerësimet* e kësaj pune nga vetë nxënësit, shokët, mësuesit e tjerë, prindërit etj.

Portofoli *duhet të përmbajë disa rubrika* të cilat vendosen nga mësuesi dhe strukturohen nga mësuesi dhe nxënësi. *Rubrikat e portofolit duhet të jenë të njëjta për çdo nxënës.*

Përcaktimi i rubrikave buron nga funksioni që ka portofoli për të nxënësin, si dhe procesin e vlerësimit. Pra, vihet theksi në elemente që nuk arrijnë të vlerësohen përgjatë vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar.

Rubrikat e portofolit të nxënësit përcaktohen nga mësuesi. Sugjerohet që një portofol të përmbajë:

- ➔ shembuj të detyrave;
- ➔ projekte, punë krijuese apo punime tematike të nxënësit;
- ➔ fletë apo shënime të vetëvlerësimit dhe të reflektimit të nxënësit për përparimin e tij;
- ➔ fletë vlerësime nga prindi, shokët, mësuesit etj.

1. Përderisa portofoli është individual dhe demonstroi procesin e të nxënësit duhet të ketë një *autobiografi të nxënësit*. Në ciklin fillor CV paraqitet nëpërmjet një përshkrimi të thjeshtë

me pak shkrim dhe shoqëruar me figura. Për ciklin e mesëm të ulët duhet të jetë e strukturuar në formën e një CV-je të thjeshtë profesionale. Ky dokument është i njëjtë për të gjitha lëndët.

2. Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra/ punë/ projekte të nxënësve që tregojnë **kompetencat apo rezultatet e të nxënit** për t'u arritur në një lëndë. Këto kanë rëndësi të dokumentohen të njëjtat për çdo nxënës, në çdo lëndë, sepse bëjnë të vetëdijshëm nxënësin dhe informojnë prindin për atë që pritet të arrijë nxënësi, drejtojnë të nxënit drejt arritjes dhe **nxisin procesin e reflektimit të të nxënit** bazuar në kritere të qarta.
3. Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë punime dhe projekte që nxënësi i ka bërë vetë, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me të tjerët, i nxitur nga tema të ndryshme mësimore, nga interesa personale dhe situata nga jeta e përditshme.
4. Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë vetëvlerësime të nxënësit; vlerësime nga shokët, prindërit etj.

VII. Vlerësimi i portofolit

Që portofoli të jetë efektiv duhet të përmbajë një element reflektues/ krahasues, ku nxënësi të krahasojë, të analizojë dhe të gjykojë për pikat e tij të forta dhe të dobëta. Duke qenë se portofoli i të nxënit është një koleksion i punimeve të nxënësit për të dëshmuar zotërimin e kompetencave (të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve), punimet individuale në një portofol janë shpesh të referuara si "objekte".

Pra, mësuesi duket të përcaktojë jo vetëm *çfarë*, por edhe si duhet të jetë "objekti" që do të përmbajë portofoli.

Rubrikat e portofolit përcaktohen edhe nga lloji i vlerësimit. Vlerësimi i nxënësit bazuar në portofol, mund të jetë i orientuar nga "procesit" ose "produkti".

Në rastin kur vlerësimi i portofolit **orientohet nga procesi**, synohet gjykimi i përparimit të nxënësit p.sh. përgjatë një tremujori, viti akademik, shkalle kurrikule etj. Në raste të tilla, nëpërmjet portofolit dokumentohet ecuria e procesit të të nxënit nëpërmjet studimit të evidencave

në fillim, gjatë dhe në fund të periudhës së përcaktuar. Nëpërmjet kësaj mënyre, evidentohen si arritjet e nxënësit, ashtu edhe mangësitë apo vështirësitë individuale.

Në këtë rast rubrikat e portofolit i referohen temave mësimore, rezultateve të të nxënës (RN) ose kompetencave për një periudhë të caktuar kohore. Pra, nëse i referohemi RN-ve, do të thotë që portofoli për çdo RN duhet të dokumentojë një punë të nxënësit në fillim, gjatë dhe në fund të realizimit të RN-së. Kërshtu si nxënësi, prindi, mësuesit apo nxënësit e tjerë shohin se si njohuritë dhe aftësitë kanë ndryshuar.

Në rastin kur vlerësimi i portofolit **orientohet nga produkti**, kemi një koleksion të punëve të nxënësit të konsideruara si më të mirat. Qëllimi në këtë rast është motivimi dhe pavarësia e nxënësit për të dokumentuar dhe reflektuar më shumë bazuar në nivelet e arritjes.

Lehtësimi i këtij procesi mund të kryhet në mënyra të ndryshme, p.sh. nxënësi mund të lihet i lirë të zgjedhë dhe të vendosë se cilat nga punët/ detyrat do të koleksionojë. Mësuesi mund të vendosë disa parametra se çfarë duhet të përmbajë portofoli dhe çfarë kriteri duhet të plotësojë detyra që të përfshihet në portofol.

Ky model portofoli nxit rritjen e përgjegjësisë së nxënësit për punë cilësore në kryerjen e detyrave. Detyrat në këtë rast duhet të shoqërohen me vetëreflektim dhe vetëvlerësim nga ana e nxënësit.

Të dy llojet e portofoleve mund të përdoren në të gjitha nivelet e shkollimit. Portofoli i orientuar nga procesi përdoret më shumë në arsimin parashkollor dhe fillor. Mësuesit në këto nivele kanë prirje të jenë më të interesuar dhe të ëpërqendruar në zhvillimin dhe në rritjen individuale të fëmijës.

Portofoli i orientuar nga produkti është më i zakonshëm në klasat e larta, për dy arsye:

- *kërkesat e larta për vlerësim të nxënësit kërkojnë mësim të orientuar nga produkti;*
- *nxënësit më të rritur, në përgjithësi, kanë më shumë pjekuri dhe aftësi për të zgjedhur punën e tyre më të mirë si dhe të angazhohen në vetëreflektim më të thellë.*

Vlerësimi i portofolit nga mësuesi realizohet nëpërmjet këqyrjes individuale ose nëpërmjet prezantimit “publik” para një paneli të përbërë nga moshatarë, mësues të profileve të ndryshme, prindër, anëtarë të tjerë të komunitetit etj. *Kjo e fundit zhvillon veç të tjerash edhe aspekte të komunikimit, shkëmbimit, argumentimit dhe mbajtjes së përgjegjësisë.*

Për të realizuar vlerësimin e portofolit mund të ndiqen mënyra si më poshtë:

- ➔ nxënësit mund të paraqesin të gjithë ose pjesë të portofolit të tyre;
- ➔ në disa raste, nxënësit mbrojnë punën e tyre;
- ➔ në raste të tjera, nxënësit i shfaqin punimet e portofolit të tyre në formë ekspozite;
- ➔ në raste të tjera nxënësit zhvillojnë një pjesë të portofolit të tyre duke reflektuar interesat individuale akademike apo të karrierës.

Rëndësia e prezantimit qëndron në krijimin e një lidhjeje në mes nxënësve dhe komunitetit.

Nxënësit rrisin vëmendjen për cilësinë dhe njëkohësisht është një mënyrë për të përfshirë më thellë në procesin e të mësuarit komunitetin, veçanërisht prindërit.

Vlerësimi i portofolit është përfshirë në paketën dhe rregulloren e vlerësimit për arsimin e mesëm të ulët.

Portofoli lehtëson vënien e notës, realizon vlerësim objektiv, si dhe plotëson procedurat tradicionale të vlerësimit.

Nxitja e vetëvlerësimit si pjesë përbërëse e vlerësimit të portofolit, krijon sa një klimë konkurruese ndërmjet nxënësve, po aq edhe përmirësimin e vetë nxënësit në ato drejtime që ai i evidenton si problematike.

Shembull: Rubrika e vlerësimit të portofolit

Rezultati i vlerësimit duhet të pasqyrojë përmbushjen e elementeve bazë që kërkohet të vlerësohen.

- Përzgjidhen të paktën 4 komponentë/çështje apo grup çështjesh që do të përfshihen në vlerësim si p.sh.:
 - detyrat e shtëpisë;
 - projektet apo detyrat për tema/ RN/ kompetenca;
 - raporte të vëzhgimeve/ punët praktike, punët laboratorike etj.;
 - raporte/ përmbledhje javore të veprimtarive të kryera nga nxënësi.

Çdo çështje është notuar me 4 nivele¹ (nga 1 te 4). Çdo nivel mund të ketë maksimumi 25 pikë dhe totali është 100 pikë.

¹ Në arsimin fillor janë 5 nivele arritjesh, kurse në ciklin e mesëm të ulët dhe të altë janë 4 nivele.

Komponenti që vlerësohet	Nivelet e arritjes				Komente/ Shënime
	1	2	3	4	

TOTALI I PIKËVE _____

Duhet përmirësim _____

Ka progres _____

Procedura/ hapat për konceptin e vlerësimit të bazuar në portofol

Për hartimin e një instrumentit të vlerësimit (listë kontrolli), zakonisht ndiqen *hapat* e mëposhtme:

- ➔ analizohen RN-it për të cilat do të vlerësohet nxënësi;
- ➔ përcaktohen kompetencat për të cilat do të vlerësohet nxënësi nëpërmjet portofolit;
- ➔ përcaktohen detyrat që duhet të realizojë nxënësi për t'u vlerësuar;
- ➔ analizohen proceset/ detyrat duke theksuar kërkesat (aspektet) më të rëndësishme të tyre;
- ➔ hartohet lista e kërkesave që duhet të përmbushë nxënësi nëpërmjet portofolit gjatë vlerësimit;
- ➔ përcaktohet skema e vlerësimit (rubrika e vlerësimit), pra pesha që ka në vlerësim secila nga kërkesat;
- ➔ strukturohet instrumenti i vlerësimit (listë kontrolli) duke vendosur edhe të dhëna të përgjithshme, si emri i nxënësit, kërkesat për proceset/ detyrat, rezultatet maksimale të mundshme (peshat), rezultatet e arritura, vlerësimi i plotë.

Struktura (formatet) e instrumenteve të vlerësimit janë nga më të ndryshmet dhe mësuesi ka pavarësi dhe fleksibilitet në konceptimin dhe hartimin e tyre.

Në vëmendje të mësuesit:

- Portofoli i të nxënit mund të përdoret në të gjitha nivelet e edukimit;
- Në klasën përgatitore dhe në arsimin fillor nxënësi ka portofolin e tij të të nxënit, të cilin e mban në klasë dhe herë pas here e rishikon për ta përmirësuar dhe plotësuar.
- Në AMU dhe AML nxënësi e mban vetë portofolin për të gjitha lëndët dhe vitet;
- Në disa raste, portofolet bëhen pjesë e përshkrimit (CV) të nxënësit dhe mund të përdoret në punë dhe në rastin e aplikimit për shkollë apo për ndërrimin e saj.
- Mësuesi mban portofolin e tij, ku krahas shumë materialeve koleksionon dhe kontributet e nxënësit. Kjo është një mënyrë për të krahasuar të dhënat.

VIII. Menaxhimi i cilësisë së portofolit të të nxënit dhe instrumentet për vetëvlerësimin e tij

Cilësia e portofolit të të nxënit është e lidhur me shumë faktorë, por rolin parësor e ka mësuesi.

Cilësia e portofolit lidhet me:

- përcaktimin e qartë të *funksionit* që ka;
- referencat ndaj *kurrikulës*;
- hapat dhe *metodologjinë* që ndiqet në planifikimin dhe zhvillimin e tij;
- *kriteret* që vendosen *për vlerësimin* e nxënësit;
- *transparencën dhe komunikimin* e përmbajtjes te kolegët, prindërit, nxënësit e tjerë;
- *digjitalizimin* e rubrikave kryesore etj.

Kriteret për monitorimin e cilësisë së portofolit lidhen:

a) Me aspekte të planifikimit të përmbajtjes së portofolit

Portofoli për një fushë/ lëndë duhet të bazohet dhe zhvillohet me të njëjtën strategji, si për mësuesin që planifikon dhe realizon mësimin (në rastin e portofolit të mësuesit) ashtu dhe për nxënësin (portofoli i të nxënit).

Pra, duhet të mbahet parasysh se qëllimi i zhvillimit të portofolit **është monitorimi dhe vlerësimi i progresit dhe i arritjeve.**

Pyetjet kyç si për **mësuesin** dhe **nxënësin** janë:

- A janë përzgjedhur dhe zhvilluar materiale që pasqyrojnë kontributin dhe progresin e nxënësit në mësim?
- A janë organizuar dhe prezantuar në mënyrëne duhur materialet, detyrat, punimet dhe shembujt e mbledhur?
- Si dhe ku duhet të ruhet dhe të mirëmbahet portofoli?

b) Me aspekte të koleksionimit të materialeve

- A është mbajtur parasysh në procesin e koleksionimit **mbledhja e materialeve apo e kontributeve** që pasqyrojnë përvojat e nxënësve në përputhje me kompetencat e kurrikulës apo të bazuar në RN të fushës/ lëndës?

- A është vendimi për përzgjedhjen e **përmbajtjes së portofolit** në raport me kompetencat e kurrikulës apo a është bazuar në RN?
- A i është referuar përzgjedhja, mbledhja e objekteve dhe e produkteve:
 - ✓ **RN/ temave/ çështjeve** të veçanta të lëndës;
 - ✓ **procesit të vazhdueshëm** të të nxënit;
 - ✓ **kontributit në projekte**, situatë të nxëni, interesa personale etj.

Të gjitha materialet e mbledhura duhet të reflektojnë qartë kriteret dhe standardet e vlerësimit.

c) Me procesin e reflektimit dhe të vetëvlerësimit

- A janë marrë parasysh treguesit e mëposhtëm për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e portofolit të të nxënit.
- I. Referuar funksionit** që ka portofoli: - A i shërbejnë punët e mbledhura nga nxënësit çështjeve si më poshtë?
 - ✓ Vlerësimit të cilësisë së mësimin dhe arritjeve.
 - ✓ Krijimit të një “arkivi” përfaqësues të punëve të nxënësve.
 - ✓ Përcaktimit nëse nxënësit i kanë përmbushur standardet e të nxënit.

 - II. Referuar përmbajtjes së portofolit:** - A janë koleksionuar në portofol dokumentet si më poshtë?
 - ✓ Detyra me shkrim;
 - ✓ Teste të përfunduara;
 - ✓ Punë krijuese;
 - ✓ Projekte;
 - ✓ Eksperimente;
 - ✓ Koleksione;
 - ✓ Prezantime;
 - ✓ Video të krijuara nga nxënësit;
 - ✓ Prezantime multimediale;
 - ✓ Fotografji, apo objekte të tjera dixhitale të të nxënit;
 - ✓ Çmime/ certifikata/ vetëvlerësime dhe rekomandime.

Portofoli mund të jetë online, digjital ose e-portofole.

III. Referuar **rubrikave** që e përbëjnë portofolin e të nxënit: - A janë koleksionuar rubrikat e portofolit në dy grupime të mëdha si më poshtë?

1. Dokumente dhe evidenca nga procesi i të nxënit.

(modele të detyrave, testeve, projekteve, prezantimeve, fotove etj.)

2. Reflektime (vetëvlerësime, vlerësime nga mësuesi, prindi, nxënësit e tjerë etj.)

Bazohet në vetëvlerësimin që duhet të bëjë nxënësi, si më poshtë.

- Çfarë kam mësuar? Pse nuk kam mësuar?
- Kur kam mësuar? Në çfarë rrethanash dhe kushtesh?
- Çfarë nxënësi jam?
- Si të organizoj një plan të plotë, të vazhdueshëm për të nxënë? Sa më ndihmojnë përvojat e shkuara?
- Ku, kur dhe si kam realizuar integrimin?
- A është e zbatueshme në praktikë ajo çfarë kam mësuar?
- Çfarë më ka bërë përshtypje gjatë procesit të të nxënit?
- Në cilat raste kam qenë krenar për arritjet? Kur jam zhgënjyer apo nuk ia kam dalë mbanë?
- Cilat aspekte të të nxënit kanë qenë të vlefshme?

Referenca

Kuithof Jon, “Student Guide to Using Learning portfolio, Mc Master University 2013.

Ligji Nr.10247, 4.30.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.

Mustafai A, Dr. Andoni M, Dr. Sula G, Thiele L, “Manual i programit të kursit të trajnimit te vazhduar për mësues dhe instruktorë në AFP për “Bazat e didaktikës në arsimin dhe formimin profesional”, GIZ, AKAFPK, 2016.

Paul Joe Mary, “Teaching and learning portfolios” Guidebook, Delta 2004.

Shtojca: Hapat për të planifikuar përmbajtjen e portofolit

Hapat që duhet të ndiqen nga mësuesi për të planifikuar detyrat që do të koleksionohen në portofol, bazohen në kriteret e mëposhtme:

Hapi I: Të menduarit për procesin e të nxënës

Tabela e mëposhtme jep një shembull se si mësuesi planifikon detyrën që duhet të dokumentohet nga nxënësi në portofol dhe cili është rezultati i të nxënës që arrihet prej saj. Kjo lehtëson mësuesin për të nxitur të nxënës dhe dokumentimin e kësaj në portofol.

Nxënësi duhet të vendoset në situata që të pyesë veten "Çfarë kam mësuar apo çfarë do të mësoj?".

Tabela 1

Detyra e realizuar/ e dokumentuar/ E koleksionuar	Njohuritë/ aftësitë/ kompetencat që demonstron kjo detyrë	Lloji i njohurive/ aftësive/ kompetencave	Kriteret që duhet të mbajë parasysh për të demonstruar njohuritë/ aftësitë/ kompetencat
Shkrimi i një raporti/ detyrë/ projekti	<ul style="list-style-type: none"> - Si të shfaqë idenë? - Si dokumentohet një veprimtari? - Si të krijojë një argument? (lidhja e ideve) - Si të bindet audienca? - Si të zbatohet një parim apo ide? 	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi; - Të menduarit kritik; - Ndërtimi i një skeme logjike; - Prezantimi, - Mbikëqyrja, përshtatja, cilat janë veprimtaritë për menaxhimin e audiencës; - Zgjidhja e problemit (A është reale zgjidhja e detyrës për situatën?) 	<ul style="list-style-type: none"> - Të menduarit kritik; - Njohuri nga lënda; - Komunikimi; - Puna në grup; - Planifikimi dhe zbatueshmëria

Mësuesi merr vendim për hapin I, duke përdorur argumentet më poshtë:

- Karakteristikat e lëndës, të kushteve të shkollës dhe nivelit të nxënësit. Mësuesi përcakton detyrat që do të seleksionojë/ apo do të dokumentohen nga nxënësi në portofol në përputhje me rezultatet e të nxënësit.
- Kriteret e përzgjedhura nga mësuesi për zhvillimin e detyrës duhet të nxisin procesin e të nxënësit.

Hapi II: Hartimi i kriterëve të të nxënësit që do të përmbushen nëpërmjet portofolit referuar lëndës dhe ciklit të shkollimit.

Meqenëse portofoli është një mekanizëm për vlerësimin e nxënësit, ka rëndësi ***hartimi i kriterëve për vlerësimin e portofolit***. Kjo përfshin kriteret si për detyrat apo projektet e dokumentuara, ashtu dhe për portofolin në tërësi.

Nëse i referohemi kolonës së kriterëve në tabelën më sipër, këto mund grupohen në tri nivele si më poshtë, duke lehtësuar procesin e gjyqimit nga ana e mësuesit si dhe procesin e reflektimit dhe vetëvlerësimit nga ana nxënësit dhe prindit (kur kriteret bëhen transparente)

Tabela 2

Niveli	II	III	IV
Të menduarit kritik	Demonstron përdorimin e një llojshmërie të mjeteve, mënyrave dhe proceseve për të menduarit kritik, zgjidhjen e problemit dhe marrjen e vendimeve.	Analizon situatën duke përdorur hipoteza të qëndrueshme dhe të besueshme gjatë procesit të të menduarit, të zbatimit dhe mekanizmave të marrjes së vendimeve.	Shfaq aftësi të evidentojë dilema, dyshime, t'i rendisë problemet, si dhe propozon një gjerësi zgjidhjesh.

Mësuesi merr vendim për hapin II, duke përdorur argumentet më poshtë:

Nëse mësuesi duhet të vlerësojë adresimin e të nxënësve në fushën e të menduarit kritik, ai duhet ta vendosë nxënësin të gjykojë:

- Cilat nga nivelet e përbushjes mund të arrijë?
- Si mund të arrijë nivelin më të lartë?

Hapi III: Hartimi i rezultateve të të nxënësve për portofolin bazuar në adresimin e kriterëve të përzgjedhura.

Tabela më poshtë jep shembull për njërin nga kriteret e përzgjedhura. Mësuesi rishkruan rezultatin e të nxënësve për të menduarit kritik, zgjidhjen e problemit, marrjen e vendimit duke adresuar kriteret.

Të menduarit kritik, zgjidhja e problemit, marrja e vendimit

Tabela 3

<p>Kriteri nga tabela 2</p>	<p>Shfaq aftësi të evidentojë dilema, dyshime, t'i rendisë problemet, si dhe propozon një gjerësi zgjidhjesh.</p>
<p>Riformulimi bazuar në rezultatin e të nxënit (shpjeguar në hapin I - Tabela1) (mbahet parasysh se mund të ketë disa mënyra për të arritur kriterin e kërkuar).</p>	<p>Shkrimi i një raporti/ detyre/ projekti sipas një formati i cili lejon që nxënësi të zbatojë skenarë të ndryshëm për detyrën duke lejuar njëkohësisht vendimarrje transparente prej tij/saj.</p>

Përcaktimi dhe shkrimi i rezultateve të të nxënit për portofolin ka rëndësi të veçantë dhe duhet të bazohet në kritere. Megjithëse janë trajtuar shpesh, po theksojmë edhe njëherë disa nga rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar RN që i referohen materialeve që koleksionohen në portofolin e të nxënit:

1. RN duhet të jenë në një linjë me kërkesat që ka kurrikula dhe rregullorja e vlerësimit për portofolin. Duhet *të shprehen me një folje apo emër foljor* dhe të fokusohen drejt aktiviteteve dhe përshkrimit efektiv të arritjes së nxënësit.
2. Përvoja unike e nxënësit, e sjellë nëpërmjet detyrave/ projekteve/ krijimeve të parashikuara duhet të jetë e dokumentuar në portofol. Për këtë arsye duhet të përfshihen kriteret që krahasojnë çfarë realizon nxënësi në lidhje me me atë çfarë është parashikuar.
3. RN duhet të adresojnë:
 - a. *Çfarë* nxënësi duhet të realizojë dhe të koleksionojë në portofol?
 - b. *Si* duhet ta realizojë?
 - c. *Pse* duhet ta realizojë (cilat nga kompetencat realizon) dhe ta dokumentojë detyrën nxënësi? Çfarë përfitimi ka?
5. Nëpërmjet RN duhet të vihet theksi te ndikimi që ka portofoli i nxënësit në aspektin shkencor për lëndën apo lidhjen ndërëndore (kompetencat e lëndës), për memorjen që krijon portofoli për zhvillimin e mëtejshëm dhe orientimin drejt të ardhmes, për aspekte të zhvillimit të tij si qytetar (kompetencat kyçe të të nxënit për gjatë gjithë jetës), por edhe te përfshirja më aktive e prindërve dhe e komunitetit në shkollë.

Shembull 1. Model për hartimin e rezultateve të të nxënit për detyrat që duhet të realizohen dhe të koleksionohen në portofol.

Aftësia që zhvillohet nëpërmjet detyrave që koleksionohen në portofolin e nxënësit: **Zgjidhja e problemit**

Kriteri: Nxiti aftësitë e punës në grup në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve në situata të ndryshme.

Rezultati i të nxënit (RN)

Merr pjesë në punën në grup për të llogaritur buxhetin në një projekt mjedisor. *(Duket që RN është i gjerë, i paqartë, që nxit vetëm të kuptuarit)*

Rishikimi i parë

Plotëson formularin/ formatin e dhënë për llogaritjen e buxhetit të duhur për një projekt mjedisor. *(Në këtë rast kemi një formulim më të qartë dhe nxitet analiza, aplikimi)*

Rishikimi i dytë

Pas diskutimit në grup të detajeve të planifikimit dhe të shpenzimit të buxhetit merr vendim sipas veçorive të projektit mjedisor. *(Nxënësi përfshihet më intensivisht në aktivitet. Kemi një nivel të lartë të të nxënit (analizë, sintezë, vendimarrje)*

Versioni final

Prezanton dhe argumenton buxhetin e hartuar në grup për një projekt mjedisor. *(Nxënësi përfshihet në veprimtari që nxitin (sintezën, të nxënit nëpërmjet situatave, të menduarit krijues etj.)*

¹ Niveli i parë i kualifikimit i referohet arsimit bazë (AMU) dhe shoqërohet me çertifikatën/dëftesën e lirimit.